

Aneksi 7

FTESË PËR OFERTË

Emri: Milieukontakt Shqipëri
Adresa: Rr. ‘Xhorxhi Martini’, Pall. Teuta Konstruksion,
Shk.3, Ap.8 Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri
E-mail: office@milieukontakt.org
Afati i dorëzimit të ofertës: 7 qershor 2024

Milieukontakt Shqipëri po zbaton projektin “*Të rinjtë për një të ardhme të qëndrueshme*” në kuadër të Programit Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Prendimor 2 (ReLOaD2), i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), duke mbështetur bashkitë në zhvillimin e mekanizmave transparente të financimit për OSHC-të, në mënyrë që të përmirësojë ofrimin e shërbimeve për qytetarët në komunitetin lokal.

Kushtet për pjesëmarrje:

Të gjithë subjektet apo personat fizik të interesuar duhet të dorëzojnë ofertën e tyre sikurse parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese deri më 7 qershor 2024, në adresën e e-mailit: office@milieukontakt.org ose në adresën postare Rr. ‘Xhorxhi Martini’, Pall. Teuta Konstruksion, Shk.3, Ap.8 Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri.

Specifikimet teknike:

Për këtë projekt, Milieukontakt Shqipëri do të zhvillojë procedurën e prokurimit për produktin sipas përshkrimeve në tabelën e mëposhtme.

Nr	Përshkrimi i produktit	Produkt	Çmimi/njësi Me TVSH (ALL)
1.	Ekspert për prodhimin e një (1) video promovuese	1	
	Totali		

Specifikime të përgjithshme teknike:

- Shkolla verore do të organizohet me pjesëmarrjen e 45 të rinjve, ekspertë dhe staf i organizatave zbatuese në Bashkinë Lushnje dhe Fushë Kosovë
- Eksperti do të jetë i angazhuar për ofrimin e shërbimit gjatë 3 ditëve të shkollës verore përgjatë periudhës **1 – 15 Korrik 2024**
- Përgatitja nga ana e ekspertit të Skenarit dhe Planifikimit të Detajuar
- Të hartoj elementët kryesor që do të përfshihen në filmim
- Preferohet që të kryhen dhe xhirime me dron në sekuenca të caktuara
- Të përdori foto dhe video të kapura gjatë aktiviteteve të tjera, që do ti vihen në dispozicion nga organizata
- Video duhet të ketë një kohëzgjatje prej 3-5 minuta
- Të përgatis një reel/video ekstrakt jo më shumë se 60 sekonda
- Video duhet të dorëzohet në HD me CD
- Me Subjektin fitues do të lidhet nje kontrate.

Kushte të përgjithshme:

- 1) Aftësi në filmim dhe redaktim
- 2) Të jetë në gjendje të ofroj ide kreative për prodhimin e videos
- 3) Të ketë aftësi për të zhvilluar një skenar të mire strukturuar dhe tërheqës
- 4) Eksperiencë në përgatitjen e Mesazheve/spoteve/videove me natyrë mjedisore/kulturore në Shqipëri
- 5) Preferohet person fizik që ushtrojnë ekspertizën e tyre në territorin e bashkisë Lushnje;
- 6) Eksperti në ofertën e paraqitur duhet të ketë të përfshirë të gjitha kostot teknike dhe logjistike (transport, dieta, etj)
- 7) Dorëzimi i ofertës do të bëhet vetëm nëpërmjet email office@milieukontakt.org brenda datës 7 qershor 2024 ose në adresën postare Rr. ‘Xhorxhi Martini’, Pall. Teuta Konstruksion, Shk.3, Ap.8 Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri.
Nuk pranohen ofertat dorazi.
- 8) Paga e subjektit/ personit fizik kryhet me transfertë bankare pas marrjes së shërbimit dhe lëshimit të faturës përkatëse ose subjekt i tatimit mbi të ardhurat 15% e cila do të zbritet si një tatim në burim.

Në ofertën e tij, ofertuesi duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit te kontaktit. Gjithashtu ofertuesit, krahas Ofertës financiare të plotësuar, e cila duhet të jetë në ALL dhe TVSH të përfshihet në kosto/çmim, duhet të paraqesin edhe këto dokumenta:

- 1) CV ku te tregohen eksperiencat e mepareshme;
- 2) Ekstraktin e QKB ne rastin kur eshte subjekt, ose ID ne rastin e personit fizik;
- 3) Ofertën financiare për produktin sipas tabelës më sipër;
- 4) Numrin e llogarisë bankare.

Operatori që ofron shërbimin me çmimin më të ulët dhe në përputhje me specifikimet teknike sipas ftesës, do të njoftohet për të nënshkruar kontratën.